



REPUBLICA E SHQIPËRISË
Këshilli i Ministrave

1130
28.02.13

V E N D I M

Nr. 135, datë 20.2.2013

PËR

**LEJIMIN E MINISTRISË SË SHËNDETËSISË PËR KRYERJEN
E PROCEDURAVE TË PROKURIMIT PUBLIK, NË EMËR DHE PËR
LLOGARI TË INSTITUCIONEVE TË VARËSISË, PËR DISA MALLRA
E SHËRBIME**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 11, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Lejimin e Ministrisë së Shëndetësisë, si organ qendror blerës, për kryerjen e procedurave të prokurimit, në emër dhe për llogari të spitaleve publike në varësi të saj, për blerjen e medikamenteve dhe materialeve mjekësore.
2. Ministria e Shëndetësisë të prokurojë fondin limit, të llogaritur si shumë e fondeve buxhetore, të miratuar për çdo spital, për secilin nga artikujt.
3. Autoritetet kontraktore, institucionet e përmendura në pikën 1, të këtij vendimi, brenda muajit shkurt, të dërgojnë në Ministrinë e Shëndetësisë, si organi qendror blerës, të dhënat, teknike e sasiore, dhe fondin përkatës, për çdo artikull që prokurohet.
4. Organi qendror blerës ka këto detyra dhe përgjegjësi:
 - a) Të zhvillojë procedurat për prokurimin e përqendruar të medikamenteve dhe materialeve mjekësore, për nevojat spitalore, përfshirë procedurat e prokurimit me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit.
 - b) Të bashkërendojë punën me autoritetet kontraktore për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave për prokurimet publike, që do të zhvillojë si organ qendror blerës;
 - c) Të verifikojë përputhshmërinë e kërkesave të dërguara nga

autoritetet kontraktore me ligjin dhe standardet në fuqi;

- ç) Të shqyrtojë dhe të miratojnë specifikimet teknike, të dërguara nga autoritetet kontraktore.

Nëse gjykohet se specifikimet teknike nuk janë përgatitur në përputhje me ligjin për prokurimet publike ose mund të shkaktojnë dështim të procedurës së prokurimit, organi qendror blerës kryen rishikimin e specifikimeve teknike, në bashkëpunim me specialistët e fushave, të institucioneve përgjegjëse ose specialistë të jashtëm, vendas a të huaj. Në këto raste, organi qendror blerës vë në dijeni autoritetet kontraktore për ndryshimet e bëra.


- d) Të unifikojë specifikimet teknike për mallra dhe shërbime të të njëjtit lloj, në përputhje me standardet e miratuara, në bashkëpunim me specialistët e fushave të institucioneve përgjegjëse ose specialistë të jashtëm, vendas a të huaj. Në këto raste, organi qendror blerës vë në dijeni autoritetet kontraktore për ndryshimet e bëra.

- dh) Të bashkërendojë punën për testimin e tregut për përlllogaritjet e të dhënave sasiore për mallrat, që do të prokurohen, para publikimit të tenderit. Në këto raste, organi qendror blerës vë në dijeni autoritetet kontraktore për ndryshimet e bëra.

5. Organi qendror blerës, në rast se autoritetet kontraktore kanë kërkesa, pasi është bërë publikimi i njoftimit të kontratës së prokurimit, verifikon arsyet e vonësës dhe vendos për shpalljen ose jo të procedurës së re të prokurimit për këto kërkesa.
6. Ngarkohet Agjencia e Prokurimit Publik të udhëzojë autoritetet kontraktore për zbatimin e këtij vendimi.
7. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe institucionet e përmendura në pikën 1, të këtij vendimi, për zbatimin e vendimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në "Fletoren zyrtare".


K R Y E M I N I S T R I



SALI BERISHA

MINISTRI I SHËNDETËSISË

VANGJEL TAVO



NR.PROT.576/1
DATË 27.2.2013

MINISTRISË SË SHËNDETËSISË
MINISTRISË SË FINANCAVE
MINISTRISË SË DREJTËSISË
AGJENCISË SË PROKURIMIT PUBLIK
QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

